




FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Newsletter Dhjetor 2019



Në Fokus

IVR, programi që zbut pabarazitë dhe nxit zhvillimin në nivel rajonal

Impakt/Histori njerëzore

Asnjë problem nga stuhia e fundit!

Banorët e Fushë-Krujës pas vitesh përmbytje, të sigurtë në banesa

HSE

Siguria në punë - Ndhimja e parë bën diferencën

Të reja nga projektet

Sheshi Italia, hapësira që bashkon kujtesën historike me të ardhmen

IVR, programi që zbut pabarazitë dhe nxit zhvillimin në nivel rajonal

Programi “Infrastruktura Vendore Rajonale” që financohet nga qeveria shqiptare përmes mekanizmit të FZHR dhe që zbatohet nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit, synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm rajonal përmes krijimit të sinergjive mes projekteve dhe rritjes së kohezionit social, ekonomik dhe territorial. FSHZH synon të promovojë një politikë të integruar investimesh; të inkurajojë një model gjithëpërfshirës bashkëpunimi; të krijojë partneritete me interes të përbashkët zhvillimi; të ndërtojë rrjetëzime rajonale dhe ndër-rajonale; të zvogëlojë dallimet dhe hendekun midis zonave të zhvilluara dhe të pazhvilluara.

Janë 25 projekte në infrastrukturë rrugore, urbanizim dhe turizëm (shih tabelën për listën e plotë) që kanë filluar të zbatohen nga FSHZH në bashkëpunim me bashkitë duke pasur objektiv kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik në kuadër të një plani më afatgjatë që shkon përtej territorit të një bashkie.

Duke analizuar potencialet e secilit rajonit, që deri tani nuk janë shfrytëzuar për shkak të mungesës së investimeve, çdo ndërhyrje është menduar që jo vetëm t’u përgjigjet nevojave në nivel rajonal, por mbi të gjitha të kapitalizojë këto potenciale.

Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/12/20/ivr-programi-qe-zbut-pabarazite-dhe-nxit-zhvillimin-ne-nivel-rajonal/>

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësitë Administrative	Emri i Nënprojektit
1	Berat	Poliçan	Vertop	Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qendrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte, fshati Fushë - Peshtan
2	Dibër	Dibër	Kala e Dodës	Rikonstruksioni i rrugës Rrugë nacionale (Ceren) - Radimirë
3	Durrës	Durrës	Durrës	Rehabilitimi i aksit rrugor Deshmoret dhe Egnatia, Loti III
4	Elbasan	Cërrik, Belsh	Gjyrale, Gostime	Ndërtim Sistemim Asfaltim i rrugës Grekan-Shelgu-Gjyrale
5	Elbasan	Elbasan	Shirgjan, Gjergjan	Rikonstruksioni i rruges Kuçan - Bujqes - Jagodine - Murriqan -Thane
6	Fier	Fier	Fier	Rikonstruksioni i segmentit të dytë të rrugës Mujo Ulqinaku dhe Segmenti i Parë i rrugës Jakov Mile
7	Fier	Roskovec	Kuman	Ndërtimi i parkut Agro turistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse fshati Luar
8	Fier	Fier, Lushnje	Mbrostar, Bubullimë	Rikonstruksioni i rrugëve që lidhin fshatrat Kallm i Vogël - Imesht - Verri - Bubullimë - Ura Beline, Nj.A Mbrostar, Fier
9	Fier	Divjakë	Divjakë	Rikonstruksioni i rrugëve të rajonit të Sotallareve
10	Fier	Lushnjë	Fiershegan, Bubullimë, Krabunarë	Rikonstruksioni i Unazës Bujqësore të Myzeqesë, rreth rrotullimi Imsht - Ngurrëz, Fier i ri, Kashtbardhë, Qerret Kadij Saver, Paketa II dhe ndërtimi i rrugës së aksesit për Qendren e Grumbullimit të frutave, perimeve dhe agrumeve.
11	Gjirokastër	Tepelenë	Q. Tepelenë	Rikonstruksioni i rrugës Salari - Dukaj (Loti II & III)
12	Gjirokastër	Tepelenë	Tepelenë	Rikonstruksioni i Rrugëve të Brendshme të Kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i Shëtitores përgjatë hyrjes së Kalasë së Ali Pashë Tepelenës
13	Korçë	Kolonjë	Ersekë	Rikualifikim Blloku Urban që kufizohet nga rrugët F. Noli, M.Pepi, A.Bektashi si dhe rivitalizimi i Parkut Rinia, Ersekë
14	Kukës	Tropojë	Bajram Curri	Unaza e qytetit Bajram Curri, Faza II
15	Lezhë	Kurbini	Laç	Sistemim asfaltim i rrugës Sanxhak - Superstradë Faza II
16	Shkodër	Shkodër	Postribë	Rikonstruksion rruga Ura e Mesit - Kala e Drishtit, Lot II & III
17	Shkodër	Vau i Dejës	Vau-Dejës	Ndërtimi i Unazës së qytetit Faza II, seg A-G, Vau i Dejës
18	Tiranë	Tiranë	Tiranë	Rikonstruksioni i Sheshit Italia
19	Tiranë	Tiranë	Tiranë	Ndërtimi i rrugës lidhëse rruga e Dibrës - Kongresi i Manastirit
20	Vlorë	Himarë	Lukovë	Rikonstruksion i rrugës Borsh - Kala e Borshit
21	Vlorë	Konispol	Xarrë	Rehabilitim i unazës Ekonomike të bashkisë Konispol, Loti I II (Shkallë - Vrime)
22	Rajonal			Përmirësimi i shtresave rrugore në rajonet 1,3
23	Rajonal			Përmirësimi i shtresave rrugore në rajonet 2,4
24	Rajonal			Përmirësimi i sigurisë rrugore
25	Rajonal			Përmirësimi i ndriçimit

Asnjë problem nga stuhia e fundit!

Banorët e Fushë-Krujës pas vitesh përmbytje, të sigurtë në banesa

“Ngeli duke u na përmyt malli dhe lagështi gjithandej. Lumi këtu ka qenë dhe më përpara o nën’, po kanë ardhur e i kanë bërë shtëpijat ngjit më ngjit e ja tani. Shyqyr kanë ardhur këta çunat, e po punojnë. Avash avash janë duke e zgjidhur.” *Nënë Zelfija*

“Kemi pa vdekjen me sy. E beson dot?! Kam nxjerrë 9 njerëz prej këtej me fadroma. Jemi përmytur dy herë në vit. Flitet për jetë njerëzish këtu.” *Z. Hysen*

“Hymë në borxhe, po duhej të ndërtonim patjetër katin e dytë, të rrinim aty sa të tërhiqej uji. Herën e fundit përmytja na la pas lluc. Besoni edhe gjarpërinj na kanë ardhur aty. Tani jemi rehat se ngelëm me sytë nga lumi.” *Banore e zonës*

“Ky është një investim jetik, që “shpëton” një qytet të tërë. Lumi Zezë ishte kthyer në makth çdo dimër, duke sjellë situatë të vështirë për familjet dhe bizneset e vogla.” *Kryetar i Bashkisë Krujë Artur Bushi*



Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/10/17/deri-dje-kati-i-pare-ishte-per-lumin-i-dyti-per-familjen/>

Siguria në punë – Ndhimja e parë bën diferencën

HSE

Ndhimja e shpejtë në situatën e një aksidenti mund të shpëtojë jetë. Por jo vetëm kaq. Ndhimja e shpejtë dhe mënyra sesi trajtohet një i aksidentuar është përcaktuese edhe për kohën e rekuperimit. Nëse është dhënë në mënyrën e duhur mund të shkurtojë kohën e shërimit dhe nëse jo mund të shkaktojë edhe më shumë dëm.

Për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e dhënies së ndihmës së shpejtë, por edhe për të rritur kapacitetet e stafit në menaxhimin e situatave të tilla, Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar (KKSH) zhvilluan një trajnim dy-ditor ku morën pjesë rreth 20 punonjës të zyrave qendrore të FSHZH dhe menaxherë të kontratave në terren.

Trajnimi i drejtuar nga ekspertë të KKSH me një përvojë 20-vjeçare, kombinoi teorinë me ushtrime praktike për menaxhimin e situatave të aksidenteve dhe ndërhyrjeve të sakta në dhënien e ndihmës së shpejtë.



Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/12/22/siguria-ne-pune-ndihma-e-pare-ben-diferencen-2/>

Sheshi Italia, hapësira që bashkon kujtesën historike me të ardhmen

Rikonstruksioni i Sheshit Italia ishte një projekt sfidues për t'u realizuar në kuptimin e kohës në dispozicion dhe integritet të tij me projektin e rëndësishëm të rindërtimit të Stadiumit Kombëtar që tashmë njihet me emrin "Air Albania". Pas një pune intensive projekti u realizua brenda vetëm 3 muajsh.

Pas rikonstruksionit sheshi ka marrë pamjen dinjitoze që i shkon për shtat stadiumit të ri të kombëtares. Përveçse një projekt madhor për sportin, stadiumi është edhe një atraksion i shtuar për turistët dhe vizitorët në kryeqytet.

Punimet për rikonstruksionin e sheshit konsistuan në ndërtimin e infrastrukturës inxhinierike nëntokësore, bashkë me linjat e sistemit të ndriçimit dhe sistemeve të tjera për të siguruar shërbimet që lidhen me parkingun nëntokësor. Pjesë e integruar e projektit ishte edhe realizimi i një rruge me dy sense lëvizjeje nëpërmjet Rektoratit dhe ish Pallatit të Kongreseve, duke zgjeruar rrugën ekzistuese dhe duke bërë një ndarje të qartë mes hyrjes së sheshit dhe rrugës drejt Pallatit të Kongreseve.

Pllakat e përdorura për shtrimin e sheshit janë tip travertine. Këto janë pllaka të përbëra nga guri gëlqeror dhe shumë rezistente. Për sheshin Italia janë përdorur travertine të kuqe dhe të bardha.

Sheshi Italia ndodhet në pjesën e pasme të godinave binjake të Rektoratit të Universitetit të Tiranës e Muzeut Arkeologjik, projektuar nga Gherardo Bosio dhe finalizuar në vitet '40 dhe Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve) që u projektua nga arkitektë shqiptarë dhe përfundoi në vitin 1986.

Nga ana tjetër stadiumi përfaqëson arkitekturën moderne edhe pse në fasadën e tij ruan gjurmët e origjinës. Pozicionimi mes godinave të ndërtuara në periudha të ndryshme e bën atë një urë lidhëse mes memories historike dhe të ardhmes që po ndërtohet tani.

